



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:055119

Datë: 11.03.2024

Numri i dokumentit: 05432577

**C.nr.1005/22**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil,** gjyqtarja Edije Sezairi, me bashkëpunëtoresh profesionale K.R. në çështjen juridike kontestimore të paditëses R.D. me numër personal ..... nga fshati .... Komuna e Prizrenit, të cilën me autorizim e përfaqësojnë avokat B.K. dhe avokate F.G. që të dy nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, vlera e kontestit 3,748.8 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë **04.03.2024**, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET pjesërisht e bazuar** kërkesëpadia e paditëses R.D. nga fshati ..... Komuna e Prizrenit, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, për shkak të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, **DETYROHET** e paditura, që paditëses, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, për periudhën kohore prej datës 23.03.2019 deri më datë 19.06.2019 apo për 3 muaj (për çdo muaj shumën prej 41.38 euro, në shkallë prej 27 % të pagës bazë – 459.00 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit), t’ia paguajë shumën prej **124.14 euro**, për periudhën kohore 20.06.2019 e deri më 18.04.2021, apo për 22 muaj (për çdo muaj shumën prej 78.1 euro, në shkallë prej 35% të pagës – 459.00 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit), t’ia paguajë shumën prej **1,718.2 euro**, apo shumën e përgjithshme prej **1,842.34 euro**, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 23.03.2022 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

**II. REFUZOHET** pjesa tjetër e kërkesëpadisë mbi shumën e gjykuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, respektivisht shuma prej **1,906.46 euro**, si e pa bazuar.

**III. DETYROHET** e paditura, që paditëses, t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

**A r s y e t i m**

Paditësja R.D. nga fshati ..... Komuna e Prizrenit, të cilën sipas autorizimit e përfaqësojnë av. B.K. dhe av.F.G. që të dy nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, vlera e kontestit 3,748.8 euro.

Në padi, pala paditëse ka theksuar është e punësuar si mësimdhënëse pranë ShFMU “Gjon Buzuku” në fshatin Gjonaj, Komuna e Prizrenit, ku vazhdon të punojë në këtë institucion. Tutje, ka theksuar se duke e llogaritur periudhën kohore nga data 18.04.2021 e deri më 18.04.2021, për 48 muaj, paditëses i ka takuar e drejta e kompensimit prej 35% të vlerës së pagës bazë, në bazë të nivelit të shkollimit. Deri në momentin kur ka kërkuar përmbushjen e këtij obligimi, e paditura ia ka kompensuar vetëm shumën prej 85.55 euro, e jo shumën prej 160.65 euro që i takon në emër të kualifikimit, respektivisht i ka mbetur pa i kompensuar shumën prej 78.1 euro. Andaj, ka propozuar që të aprovohet e bazuar kërkesëpadia e paditëses, të detyrohet e paditura t’ia kompensojë shumën e përgjithshme prej 3748.8 euro, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, me kamatë ligjore prej 8% , si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore.

E paditura, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar, duke kërkuar që gjykata të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar. Ka theksuar se pretendimi i paditëses se i takon kompensimi për licencim është në kundërshtim me nenin 2 par. 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit, sepse në atë dispozitë shkruan se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm për anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK-ut, ndërsa paditësja nuk ka paraqitur fakte se është anëtar i kësaj sindikate, nuk ka dëshmuar me anë të kartelës së anëtarësisë. Po ashtu ka theksuar se paditësja ka ushtruar padi në gjykatë për realizimin e të drejtave pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren, që do të thotë se paditësi nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative, ashtu që i janë drejtuar gjykatës në kundërshtim me nenin 124 par. 6.1. të Ligjit për Procedurën Administrative, dhe me këto veprime të paditurës i shkaktojnë shpenzime të mëdha, sepse obligohen të paguajnë edhe shpenzimet e procedurës gjyqësore. Sa i përket obligimit lidhur me përmbushjen e detyrimit, e paditura në përgjigjen në padi thekson se vet Komuna e Prizrenit nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive, përkatësisht Qeveria e Republikës së Kosovës është garantues i implementimeve të KKAK-së, andaj Komuna e Prizrenit nuk ka kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që burojnë nga KKAK-ja. E paditura ka kontestuar kërkesëpadinë duke u bazuar në nenin 353 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, duke deklaruar se paditësja ka humbur të drejtën për realizimin e kërkesës, pasi që ka kaluar afati 3 vjeçar, ashtu që ka arritur parashkrimi i kërkesës së paditëses. Me të gjitha të cekurat si më lartë, e paditura ka kërkuar që kërkesëpadia e paditëses të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësja R.D. është në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënëse pranë shkollës “Gjon Buzuku” në Prizren. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditëses i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, përkatësisht diferencës konkrete të papaguar.

Në këtë drejtim, gjykata nga kontrata e punës me numër të protokollit 778 të datës 03.10.2019 e lidhur ndërmjet paditëses dhe të paditurës, rezulton se paditësja është e punësuar tek e paditura si mësimdhënëse e matematikës dhe se ka kualifikim universitar të ciklit të dytë, respektivisht e njëjta ka përfunduar studimet master në fakultetin e edukimit, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 467, e datës 03 korrik 2019, e lëshuar nga Universiteti

i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, në emër të paditëses, ku e njëjta ka marrë titullin master i mësimdhënies lëndore (me specializim në matematikë).

Në vazhdim, bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditëses është në shumë prej 459.00 euro dhe se paditëses në emër të kualifikimit master, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 82.55 euro.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se “shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”. Andaj meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që “nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se “mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”. Pastaj, bazuar në mendimin juridik të Gjykatës Supreme nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që “për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”, vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditëses t’ia paguaj kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe kontrata e punës nr.778 të datës 03.10.2019, rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, ia ka paguar shumën prej 82.55 euro. Sipas pikës 4 nën pikës 3 të Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008, paditësja përfiton ngritje për periudhën nga data 23.03.2019 e deri me datë 19.06.2019 në lartësi prej 27% ndërsa për periudhën nga data 20.06.2019 deri me datë 18.04.2021 në lartësi prej 35 % të pagës bazë. Andaj, gjykata vendosi si në pikën nën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditëses për periudhën prej datës 23.03.2019 deri me datë 19.06.2019, për çdo muaj t’ia paguaj diferencën e papaguar në shumën prej 41.38 euro, apo shumën e tërësishme për këtë periudhë në vlerë prej 124.12 euro, ( $3 \times 41.38 = 124.14$ ), ndërsa për periudhën kohore prej 20.06.2019 deri me 18.04.2021, apo për 22 muaj, për çdo muaj t’ia paguaj diferencën e papaguar në shumën prej 78.1 euro apo shumën e tërësishme për këtë periudhë në vlerë prej 1,718.2 euro ( $22 \times 78.1 = 1,718.2$ ), e që në total

detyrimi i të paditurës ndaj të paditurit arrin në vlerë prej 1,842.34 euro (124.14 + 1718.2=1,842.34).

Gjykata i ka njohur paditëses të drejtën e saj për kompensim në kualifikim për periudhën prej 23.03.2019 deri me datë 19.06.2019, në lartësi prej 27% (pra për nivel të studimeve bachelor), për faktin se nga diploma me numër 467, e lëshuar në emër të paditëses gjykata ka vërtetuar se e njëjta ka mbaruar studimet e nivelit master me datë 20 qershor 2019, e që për këtë nivel duhet të i kompensohet 35% në pagën bazë. Ndërsa nga diploma me numër 1321 të datës 26 gusht 2015 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit – Qendra në Prizren, paditësja ka përfunduar studimet bachelor me datë 27 qershor 2014, ku ka marrë titullin bachelor e programit matematikë – informatikë.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë më datë 23.03.2022, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Në anën tjetër, sa i përket pjesës refuzuese, gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të LP-së shprehimisht theksohet që “të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Në këtë drejtim, paditësja padinë pranë kësaj gjykate e ka parashtruar më datë 23.03.2022, ndërsa kërkesa e saj ka qenë për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditëses iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data 18.04.2017 e deri më datë 22.03.2019. Më konkretisht, sipas llogaritjes së gjykatës, një kërkesë e tillë është parashkruar për 23 muaj apo në shumën prej 1,976.3 euro, ndërsa gjykata ka refuzuar shumën prej 110.16 euro për periudhën nga data 23.03.2019 e deri më datë 19.06.2019 për faktin se për këtë periudhë paditëses i takon shuma prej 27% e pagës bazë, respektivisht shuma prej 41.38 euro, pasi që 27 % i pagës bazë 459 euro është shuma prej 123.93 euro, e meqenëse paditëses i është paguar shuma prej 82.55 euro në emër të kualifikimit, atëherë i takon vetëm shuma prej 41.38 euro, për faktin se në këtë periudhë paditësja ka pasur kualifikim universitar bachelor, e që i takon 27% e jo 35% i pagës bazë, pasi që studimet master paditësja i ka përfunduar me datë 20.06.2019.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”. Po ashtu, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe në kuptim të nenit 399 par. 1 të LPK-së, pasi që pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses është e pabazuar në dispozita ligjore. Në këtë drejtim, sipas nenit 399 par. 1 të LPK-së parashihet që “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike, përpos kundërshtimit për parashkrim të cilën gjykata e vlerësoi të bazuar

Numri i lëndës: 2022:055119  
Datë: 11.03.2024  
Numri i dokumentit: 05432577

dhe e sqaroi më lartë. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449 dhe 453 të LPK-së lidhur me nenin 463 par. 1 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditëses t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 124.00 euro, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, për përpilimin e padisë shumën prej 104 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 20 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 398 e 399 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil**  
**C.nr.1005/22 më datë 04.03.2024**

**Gjyqtare**  
**Edije Sezairi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe për palët.